

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 15.02.2006 "Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm antikorrupsion të Këshillit të Ministrave" dhe të urdhrit të Kryeministrit nr.1352, datë 18.3.2015 si dhe programin përkatës, grupi i kontrollit të Njësisë të Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion ushtroi kontroll për zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura në Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor lidhur me zbatimin e procedurave ligjore në përzgjedhjen e distributorëve farmaceutikë, lidhjen e kontratave e zbatimin e tyre, si dhe procedurat e pagesave.

I. ZBATIMI I PROCEDURAVE LIGJORE NË PËRZGJEDHJEN E DISTRIBUTORËVE FARMACEUTIKË DHE LIDHJEN E KONTRATAVE

Grupi i kontrollit të Njësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion, (këtu e më poshtë *NJKBA-ja*), sipas programit verifikoi zbatimin e procedurave ligjore në përzgjedhjen e distributorëve farmaceutikë dhe nga verifikimi konstatohet se:

I. A – Kontratat e vitit 2014

Bazuar në vendimin nr.48, datë 10.12.2013 të Këshillit Administrativ të Fondit "Për kriteret që duhet të plotësojnë depot e barnave për lidhjen e kontratës me Fondin dhe procedurat për lidhjen e tyre si dhe në udhëzimin nr.14, datë 19.12.2013 "Për lidhjen e kontratave me Depot Importuese dhe Distributorë të Barnave për vitin 2014", lidhja e kontratës midis Fondit dhe Importuesit/Shpërndarësit Farmaceutik bëhet për Depot Importuese dhe Distributorë që plotësojnë dhe dorëzojnë pranë Fondit, dokumentet e mëposhtme:

1. Formularin tip të vetdeklarimit
2. Inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimburohen
3. Inventarin e gjendjes fizike të barnave të skaduara
4. Listën e barnave (Aneksi A)
5. Autorizimin e kompanisë farmaceutike prodhuese vendase ose të huaj për tregtimin e barnave në Shqipëri.
6. Kopjen e noterizuar të certifikatës së ushtrimit të profesionit për drejtuesin teknik, lëshuar nga Urdhri i Farmacistëve.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratat e lidhura me importuesit farmaceutikë për vitin 2014, rezulton se ka mangësi në dokumentet e kërkuara.

Konkretisht:

1. Për kontratën e lidhur me Avicena:
 - ✓ mungojnë 6 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A; Actavis, Balkanpharma, Synthon, Glaxosmithkline, Pro Med Cs Ceci dhe Boringeringeheim.
 - ✓ Kontrata nuk ka datë nënshkrimi dhe në të nuk është përcaktuar data e hyrjes në fuqi dhe afati i vlefshmërisë, pra është e pavlefshme.

2. Për kontratën e lidhur me Bylis Pharma, Tiranë:
 - ✓ mungojnë 4 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A; Bouchara-Recordati Francë, Pierre Fabre Francë, Recordati Itali dhe Theramex Monaco.
3. Për kontratën e lidhur me Bylis Pharma, Fier:
 - ✓ mungon Aneksi A ku përcaktohen barnat që do të importohen
4. Për kontratën e lidhur me Gedi Farm:
 - ✓ autorizimi për kompaninë importuese Crescent Pharma Angli është lëshuar në 18.3.2009 dhe nuk përcakton afatin e vlefshmërisë.
 - ✓ mungon autorizimi me kompaninë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A, Ayrton Saunders Limited Angli.
5. Për kontratën e lidhur me Pegasus:
 - ✓ mungojnë 4 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A, Pfzier - Belgjikë, Hungari, Francë Gjermani, Angli, Kern Pharma Spanjë, Specifar Greqi dhe Alcon Laboratoires Belgjikë, Angli, Spanjë;
6. Për kontratën e lidhur me Pharma one:
 - ✓ mungojnë 3 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A; Actavis, Malta, Bullgari, Rumani, Serbi, Itali, Uni Pharma Greqi dhe Interchemia Poloni, Austri.
7. Për kontratën e lidhur me R&S Farma:
 - ✓ mungojnë 2 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A, Fresenius Kabi Austri dhe Niche Generics Ltd Irlandë.
8. Për kontratën e lidhur me Rejsi Farma:
 - ✓ mungojnë 18 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A, Glaxo SK Europë, Bayer Schering, Actavis, Novartis Europë, Novo Nordisk Gjermani, Astra Zeneca, Berlin Chemie, Ebeëe Pharma Austri, Fresenius Austri, Gebro Pharma Austri, Niche Generics Angli, Genzyme, La Roche Zvicër, Mundi Pharma, Hexal, 1A – Pharma, Sandoz, Lek dhe, Këizda Austri.
9. Për kontratën e lidhur me Sat Farma:
 - ✓ mungon autorizimi me kompaninë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A, Taro Pharmaceutical Industries Kanada.
10. Për kontratën e lidhur me Megapharma shpk:
 - ✓ mungon Aneksi A ku përcaktohen barnat që do të importohen
11. Për kontratën e lidhur me Medicamenta:
 - ✓ Mungojnë 9 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A; ABC Int Pharma Itali, Chiesi Pharmaceutica Itali, Dolorgiet & Co Gjermani, Fidia Farmaceutici Itali, Stada Gjermani, Hemofarm Serbi, S.C.AC Helcor Rumani, Teofarma Itali dhe Ph & t Itali.
12. Për kontratën e lidhur me Intermed shpk:
 - ✓ mungojnë 13 autorizimet me kompanitë importuese për barnat e përcaktuara në Aneksin A, Nobel Ilac Turqi, Astellas Pharma Itali, Intendis Manufacturing Itali, Schering Gjermani, Alvogen, Hospira Uk Limited, Profarma Shqipëri, Berlin Chemie Gjermani, Geymonat Itali, Bosnalijek Bosnje Hercegovinë, Glaxo Angli, Aspen Europë Gmbh, Radofarma.